EUROPORT SHËNGJIN – EAGLE OF THE ADRIATIC

BOTIME NË GAZETA DHE BURIME PUBLIKE

Datë: 09.10.2026 | Dosja nr. 7284 | Lirim Muharemi

Artikuj, publikime në internet, përmbledhje burimore dhe shënim sqarues.

RENDI I SHTOJCAVE

P20	Preç Zogaj – botim / përkthim, 24.02.2013	1 f.
P26	Preç Zogaj – përmbledhje burimore	1 f.
P27	Xhevair Ngjeqari – përmbledhje burimore	1 f.
P28	SOT – Haxhinasto, Muharemi, Europort	5 f.
P29	IBNA – porti i Shëngjinit, 27.11.2013	3 f.
P30	Shqiptarja.com, 11.09.2014	3 f.
P31	Europorti i Shëngjinit – botim dhe skica	5 f.
P32	A1 Report – publikim, 11.09.2014	2 f.
P33	Bukuresht – përmbledhje dhe burime publike	1 f.
P34	Shqiptarja.com, 27.11.2013 – faqet 12 dhe 7	3 f.

Faqet burimore ruhen pa ndryshime. Numrat P të shtojcave mbeten të pandryshuar.

P01–P19 janë paraqitur më parë dhe nuk përfshihen në këta dy skedarë.

Translation of the article, available on link
http://www.panorama.com.al/2013/02/24/zogaj-ne-6-muajt-e-pare-te-qeverisjes-do-te-ndertojme-europortin-e-shengjinit/
Published on Gazeta online ...

Zogaj: In the first six months of government will build Europort in Shengjini

Last news, politics Sunday, February 24, 2013 | 10:41 pm


Zogaj speaking at the SP Convention

During the proceedings of the Convention of the Socialist Party, Prec Zogaj was introduced yesterday as representatives of the Forum for Development and emphasized that within the first 6 months of the new government will launch ports concessioning of tourism in Albania. "Resurrection, sea extraction of lethargy, change, turning the sea into a major source of employment, growth and prosperity for Albania and Albanians should start by setting the sea just to the top priorities of the government, by taking possession of marine space to restore public policy by building new short, medium and long-term studies and projects with concrete measures and initiatives related organically within a comprehensive vision for ports, fisheries, tourism, and to establish euroballkanik transit through our territory. Albanian coast provides favorable conditions for the construction of tourist harbors and fishing ports because owns bays, river delta, lagoons, coastal lowlands and the presence of construction material. What I want to emphasize in this forum is the necessity to start building the first concession tourist ports in the country within the first half of the new government. Sea policy, a priority of the new government, syllable would require all elements which are necessary to give life to industry as the product of sea-government interaction Privatbank. Immediate release of existing ports turned into cemeteries berths, efficient management of marine space, concession building new fishing ports based on studies conducted step by step creation of the fishing fleet by encouraging lending policies, support existing initiatives and qualitative expansion of vocational education for the fishing industry with all its accessories - all these are key issues the new government package to set foot in the seafood industry, "said Zogaj. Priority, according to leftists, and will be building Europort in Shëngjini. "Our study of commercial ports in the coastline provides Europort concession building with Shëngjini in a deep rocky coast for boats up to 500 thousand tons. In full sovereignty and decision-making responsibility, Albania, its new government, will decide this concession building with large port, which will be works that would include Albania titled full map of regional economic interests and beyond, "said Prec Zogaj.

P26 PREÇ ZOGAJ

PËRMBLEDHJE BURIMORE

Shqiptarja.com, 24.02.2013

Zogaj: Deti, një mundësi e re për një erë të re në ekonomi

Kontrolluar më 08.10.2026. Përmbledhje e përgatitur për bashkëlidhje; nuk është kopje arkivore ose transkript i plotë i publikimit.

Publikimi paraqet pjesë të fjalimit të mbajtur një ditë më parë në konventën e Partisë Socialiste. Përmendet ndërtimi me koncesion i Europortit të Shëngjinit në bregdet shkëmbor të thellë, për anije deri në 500 mijë tonë. Folësi e përshkruan si projekt me studim të plotë dhe njohje ndërkombëtare. Referenca për gjashtëmujorin e parë lidhet me fillimin e ndërtimit të porteve turistike, jo shprehimisht me përfundimin e Europortit.

Ky burim mbështet trajtimin publik të një projekti konkret; nuk përmend emrin e Lirim Muharemit në pjesën përkatëse.

Burimi për verifikim:

https://shqiptarja.com/lajm/zogaj-deti-nj-euml-mund-euml-si-e-re-br-p-euml-r-nj-euml-er-euml-t-euml-re-n-euml-ekonomi

P27 XHEVAIR NGJEQARI

PËRMBLEDHJE BURIMORE

Tema, 01.05.2013, 19:18

Kush e pengon ndërtimin e Europortit të Shëngjinit?

Kontrolluar më 08.10.2026. Përmbledhje e përgatitur për bashkëlidhje; nuk është kopje arkivore ose transkript i plotë i publikimit.

Artikulli i nënshkruar nga inxhinieri Xhevair Ngjeqari e identifikon Lirim Muharremi si administrator dhe pronar të projektit. Përmend dorëzimin e një vlerësimi të World Finance më 24.11.2009 dhe emërtimin Europort Shëngjin (Eagle of Adriatic). Autori përshkruan gjithashtu zgjedhjen e vendndodhjes nga investitori dhe porositjen e studimit e projektit në fazën e fizibilitetit të avancuar.

Kjo është një deklaratë publike e autorit në vitin 2013. Cilësimi i pronësisë në artikull kërkon vlerësim së bashku me kontratat dhe dokumentet burimore; artikulli nuk i zëvendëson ato.

Burimi për verifikim:

https://www.gazetatema.net/2013/05/01/kush-e-pengon-ndertimin-e-europortit-te-shengjinit-i35038

SHTOJCA P28

SOT – Artikulli mbi ministrin Edmond Haxhinasto, projektin Europort Shëngjin dhe Lirim Muharemin

Burimi i bashkëlidhur: kopje e materialit të dorëzuar për shqyrtim. Faqet vijuese riprodhojnë dokumentin pa ndryshime përmbajtësore.

POLITICAL

Haxhinasto at Klik Ekspo Group: New Shengjin Port, strategic project

WRITTEN BY SOT.COM.AL
26 NOVEMBER 2013

Facebook WhatsApp Twitter Email



One of the most serious projects of the Albanian infrastructure, that of the construction of the new Port of Shengjin will be presented to the Chinese government for securing financing for its construction - stated the Minister of Transport and Infrastructure Edmond Haxhinasto before the media present yesterday during the visit at the Tirana International Fair organized by Klik Ekspo Group. During the visit and meetings with the participating companies, Minister Haxhinasto also stopped at the Europort stand Shengjin "Adriatic Eagle". During the conversation with Lirim Muharemi, the head of the company LM & Co, Minister Edmond Haxhinasto said that the government evaluates the realized project and that it will give maximum support for finding funds. Minister Haxhinasto also congratulated the organizers of Klik Ekspo Group for the support they give to local and foreign business and consequently to the Albanian economy. At the stop at the stand of Europort Shengjin "Adriatic Eagle",

the minister explained to the media that this is one of the largest infrastructure projects and is a project that meets the needs of the country.

"One of the stands where I stopped with special interest is this one here, which presents a project like the one for the new Port of Shengjin. I would like to express my maximum appreciation for Mr. Lirim Muharremi, for his enterprise, for the realization of this project, which is in fact a very strategic project that coincides with our strategy for the development of Albania's infrastructure. We have already made this project part of our strategic plans for the development of transport and infrastructure and we are working to guarantee the interest, participation and investments of prestigious companies ", - said Haxhinasto at the Tirana International Fair. The Minister of Transport and Infrastructure expressed his conviction that the construction of the new modern port will benefit the entire region. "We will do our best to find a strategic investor to enable the realization of this important project, which is not only a project for Albania, but for Kosovo, Serbia, Bulgaria and the entire region. It is a node with extraordinary potential for development for Shengjin and all of Albania ", said Haxhinasto.

Ad closed by Google

Referring to the current situation, the head of Transport explained that the success of the implementation of major projects is a close cooperation between the government and investors and private entrepreneurs. "I think it is important to emphasize that this way of cooperation between the public and private sector will be further developed in the future. Our plans, our requirements, our investment needs are extraordinary. We will apply those forms and models which have been successful in many countries of the world. These models consist of engaging the public and private sector together to implement these important projects that subsequently affect employment, economic development and the well-being of citizens. I highly appreciate your presence, Mr. Muharemi, and I am convinced that this important project will soon have partners that will be engaged to implement it ", - said the Minister of Transport and Infrastructure. At the stand where the Minister stopped for a long time, the journalists asked for more details about the Shengjin Port project, and to their interest Minister Haxhinasto responded by saying: “Currently it will be one of the projects that we will present at the meeting that "Prime Minister Edi Rama will have a meeting with the Prime Minister of the Republic of China, which will take place in Bucharest."

BREAKING NEWS
"KORRUPSIONI NJE MAL I MADH NE SHQIPERI", YURI KIM JEP MESAZHIN E FORTE, BEN KERKESEN E PAPRIT...

POLITIKE

Haxhinasto në Klik Ekspo Group: Porti i ri i Shëngjinit, projekt strategjik

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
26 NËNTOR 2013

Facebook WhatsApp Twitter Email



Një prej projekteve më serioze të infrastrukturës shqiptare, ai i ndërtimit të Portit të ri të Shëngjinit do t`i prezantohet qeverisë kineze për sigurimin e një financimi për ndërtimin e tij - deklaroi Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës Edmond Haxhinasto para medies së pranishme dje gjatë vizitës në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës të organizuar nga Klik Ekspo Group. Gjatë vizitës dhe takimeve me kompanitë pjesëmarrëse, Ministri Haxhinasto ndaloi dhe në stendën e Europort Shëngjin "Shqiponja e Adriatikut". Gjatë bisedës me Lirim Muharemin, drejtuesin e kompanisë LM & Co, Ministri Edmond Haxhinasto tha se, qeveria e vlerëson projektin e realizuar dhe se do të japë mbështetjen maksimale për gjetjen e fondeve. Ministri Haxhinasto përgëzoi dhe organizatorët e Klik Ekspo Group për mbështetjen që i japin biznesit vendas dhe të huaj dhe rrjedhimisht ekonomisë shqiptare. Në ndalesën në stendën e Europort Shëngjin "Shqiponja e Adriatikut", ministri sqaroi për mediat se ky është ndër projektet më madhore të infrastrukturës dhe është projekt që plotëson nevojat e vendit.

"Një nga stendat ku unë kam ndaluar me interes të veçantë është kjo këtu, që bën prezantimin e një projekti si ai për Portin e ri të Shëngjinit. Dëshiroj të shpreh vlerësimin tim maksimal për zotin Lirim Muharremi, për sipërmarrjen e tij, për realizimin e këtij projekti, i cili në fakt është një projekt shumë strategjik që përputhet dhe me strategjinë tonë të zhvillimit të infrastrukturës së Shqipërisë. Ne tashmë këtë projekt e kemi bërë pjesë të planeve tona strategjike për zhvillimin e transportit dhe infrastrukturës dhe jemi duke punuar që të garantojmë interesin, pjesëmarrjen dhe investimet e kompanive prestigjoze", - tha Haxhinasto në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës. Ministri i Transporteve dhe Infrastrukturës u shpreh i bindur se ndërtimi i portit të ri modern do t`i vlejë të gjithë rajonit. "Ne do përpiqemi maksimalisht që të gjejmë një investitor strategjik për të bërë të mundur realizimin e këtij projekti kaq të rëndësishëm, që nuk është projekt vetëm për Shqipërinë, por për Kosovën, Serbinë, Bullgarinë dhe për gjithë rajonin. Është një nyje me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim për Shëngjinin dhe gjithë Shqipërinë",u shpreh Haxhinasto.

Duke u ndaluar në situatën aktuale, kreu i Transporteve shpjegoi se suksesi i realizimit të projekteve madhore është një bashkëpunim i ngushtë mes qeverisë dhe investitorëve e sipërmarrësve privatë. "Mendoj se është e rëndësishme që të theksohet se, kjo mënyrë bashkëpunimi mes sektorit publik dhe privat do të zhvillohet më tej në të ardhmen. Planet tona, kërkesat tona, nevojat tona për investime janë të jashtëzakonshme. Ne do të aplikojmë ato forma dhe modele të cilat kanë pasur sukses në shumë vende të botës. Këto modele konsistojnë në angazhimin e sektorit publik dhe privat së bashku për të realizuar këto projekte të rëndësishme që më pas ndikojnë në punësim, zhvillimin ekonomik e mirëqenien e qytetarëve. Vlerësoj maksimalisht praninë tuaj zoti Muharemi dhe jam i bindur që ky projekt i rëndësishëm shumë shpejt do të ketë dhe partnerët që do të angazhohen për ta realizuar", - u shpreh Ministri i Transporteve dhe Infrastrukturës. Në stendën ku dhe ministri ndaloi me gjatë, gazetarët pyetën për detaje të tjera për projektin e Portit të Shëngjinit, dhe interesit të tyre ministri Haxhinasto ju përgjigj duke thënë se: "Aktualisht do të jetë një nga projektet që ne do të paraqesim në takimin që kryeministri Edi Rama do të ketë me kryeministrin e Republikës së Kinës, takim që do të zhvillohet në Bukuresht".

Taboola Feed

"Keni përfitimet tuaja! Shkuat në Paris me ca para...", Frrok Çupi i 'çjerr maskën' Robert Budinës pasi iu bashkua PD: Sfida ime jo të bëhem deputet! (REPLIKAT)

Analisti Frrok Çupi ka shpërthyer mbrëmjen e djeshme ndaj regjisorit Robert Budina dhe kauzës së tij për të mbrojtur Teatrin Kombëtar

Precious Won't Apologize For Her New Figure

Weight loss groove | Sponsored

SHTOJCA P29

IBNA – China is offered the strategic port of Shengjin in Albania, 27.11.2013

Burimi i bashkëlidhur: kopje e materialit të dorëzuar për shqyrtim. Faqet vijuese riprodhojnë dokumentin pa ndryshime përmbajtësore.

China is offered the strategic port of Shengjin in Albania, after roads in FYROM and Montenegro

By Albanian Newsroom/ Published on: 27/11/2013



Tirana, November 27, 2013

IBNA Special Report/ Chinese investments in the Balkan region have seen a rapid growth in the recent months. After penetrating FYROM and Montenegro, big Chinese companies have won tender bids for the construction of several highways. Now, China, a country with 1.5 billion people is interested in the sea ports of Albania with 3.5 million people.

Minister of Transport and Infrastructure, Edmond Haxhinasto says that the Albanian government has decided to hold negotiations with China in order to build the port of Shengjin.

LAST NEWS


Turkey: 44 Turkish companies among the top 250 International Contractors


Kosovo: PM signs €138 million agreement with EU on IPA projects


Croatia: Authorities hold commemoration of Serb victims in Grubori village


Montenegro: Traffic on border crossings at 20% of last year's figures


Cyprus: Defense Minister heads to Berlin to attend

"One of the most serious projects of the Albanian infrastructure, that of the construction of the new Port of Shengjin will be introduced to the Chinese government in order to secure funding for its construction", says Mr. Haxhinasto.

"This is a very strategic project which is in line with our strategy for the development of infrastructure in Albania. We have made this project part of our strategic plans for the development of transport and infrastructure and we're working to secure interest, participation and the investments of prestigious companies", said Haxhinasto.

"The government will soon introduce a project to Chinese investors in order to find a way to realize it", added Haxhinasto.

Other sources from the Council of Ministers say that the project of this port will be presented in the meeting that prime minister of Albania, Edi Rama will have with the prime minister of the Republic of China in Bucharest.

The project costs 2.2 billion Euros and it's a port for which full feasibility has been carried out.

Minister of Transports and Infrastructure says that the construction of the new modern port will serve to the entire Balkan.

"We will try to find a strategic investor in order to realize this important project, which is not only a project for Albania, but also for Kosovo, Serbia, Bulgaria and the entire region. It's a potential extraordinary junction for the development of Shengjin and the entire Albania", said Haxhinasto.

Our project designers have named it the "Albania of Adriatic" Europort, Shengjin. According to them the implementation of the new project for the port of Shengjin will offer the possibility of development of the entire Balkan region, especially in the growth of trade exchanges in the Balkan with countries from all around the world.

The port is foreseen to be built in the rocky seacoast of Shengjin heading toward Velipoja, a very deep seacoast, which processes in a natural way ships up to 400 thousand tons. /ibna/

SHTOJCA P30

Shqiptarja.com – “Rruga e Arbrit”, Shqipëria dhe Kina, 11.09.2014

Burimi i bashkëlidhur: kopje e materialit të dorëzuar për shqyrtim. Faqet vijuese riprodhojnë dokumentin pa ndryshime përmbajtësore.

[Shqiptarja.com]

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 
ISSH miraton indeksimin 4.1% për mbi 770 mijë pensionistë, indeksimi 4.1% merr 'vulën' në qeveri javën e ardhshme! Pensionet urbane mesatare rriten 752 lekë, ruralet 453 lekë

2 
Vrau dhe groposi Kejsi Hysën në 2018, autori ekstradohet nga Italia pas 6 vitesh arrati! I dënuar me 30 vite burg

3 
Dosja 'Partizani'/ Xhim Begeja: Ju besova verbërisht, sepse Gita me Abin më garantuan! SPAK zbardh skemën: Si ndikoi Berisha në privatizimin e kompleksit

Politikë

'Rruga e Arbrit', Shqipëria e Kina drejt përfundimit të marrëveshjes

Qeveria shqiptare dhe ajo kineze janë në prag të përfundimit të një marrëveshje për financimin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Lajmi është bërë i ditur nga vetë kryeministri shqiptar Edi Rama gjatë një interviste për radion e jashtme kineze 'CRI'. ***Rama: Qeveria kineze, interes për projektin e hekurudhës, 'Korridorin e Kaltër' dhe portin e Shëngjinit***

VIDEO



[Sh].com Redaksia
11 Shtator 2014, 11:06 | **Përditesimi:**

Share Post

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

PEKIN - Qeveria shqiptare dhe ajo kineze janë në prag të përfundimit të një marrëveshje për financimin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Lajmi është bërë i ditur nga vetë kryeministri shqiptar Edi Rama gjatë një interviste për radion e jashtme kineze 'CRI'.

Rama është shprehur se për ndërtimin e 'Rrugës së Arbrit' ka biseduar me homologun kinez Li Keqiang, me të cilin zhvilloi një takim zyrtar ditën e djeshme. Takimi i dy kryeministrave u zhvilluan në Tianjin, ku të dy udhëheqësit ndodheshin për të marrë pjesë në Forumin Veror Ekonomik të Davosit.

Ndër të tjera Rama theksoi gjithashtu se qeveria kineze ka paraqitur interes edhe në sektorë të tjerë të infrastrukturës si ai për projektin e hekurudhës shqiptare, "Korridorin e Kaltër" si dhe portin e "Shëngjinit".

Gjithashtu qeveria kineze do të financojë 10 milionë juan ose 126 mijë euro për të arsimin në Shqipëri. Mësohet se kjo është një dhuratë e qeverisë kineze për transformimin e mësimdhënies përmes inovacionit në vendin tonë.

Gjatë takimit mes kryeministrave të dy vendeve janë diskutuar gjithashtu ehde projekte për zhvillimin e bujqësisë dhe peshkimit, por deri tani nuk është bërë publik ndonjë marrëveshje konkrete midis dy qeverive.



Share
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

SHTOJCA P31

Europorti i Shëngjinit – publikim me planimetri dhe përmendje të Lirim Muharemit (printim: 23.11.2018)

Burimi i bashkëlidhur: kopje e materialit të dorëzuar për shqyrtim. Faqet vijuese riprodhojnë dokumentin pa ndryshime përmbajtësore.

Like 28K Follow Spremljaj 75 Follow 89 Izberite jezik

ACP Albanian Construction Portal

kerko produkte, kompani

Kompani Produkte Projekte


Lajme Arredim & How-To Inovacion Panaire Imobiliare Kërkësë/Ofertë

kerko ndertues, projektues, investitor... Kerko

Europorti i Shengjinit


Europorti i Shengjinit

Pas vitesh përpjekjesh dhe studimesh, themeluesi i projektit më të madh në detin Adriatik, Lirim Muharemi, Presidenti &CEO e LM&CO , duket se ka gjetur një terren të përshtatshëm në Shqipëri për zhvillimin dhe implementimin e këtij projekti. Projekti Europorti i Shengjinit -Shqiponja e Adriatikut duket se po shkon drejt një udhe të mbarë dhe është në proces finalizimi.



Deklarata e Hazhinastos

Ministri i Transporteve, Edmond Haxhinasto, gjatë një vizite në panairin "Klik Ekspo Group", u shpreh se, së shpejti qeveria do ta paraqesë projektin Europorti i Shengjinit para investitorëve kinezë, por jo vetëm, për të gjetur mundësinë e realizimit të tij. Sipas projektuesve, realizimi i projektit kushton 2,2 miliardë euro. Ky është një port i projektuar në fazën e fizibilitetit të plotë. Autorët kanë preferuar ta quajnë Europorti "Shqiponja e Adriatikut", Shëngjin. Porti parashikohet të ndërtohet në bregdetin shkëmbor të Shëngjinit në drejtim të Velipojës, bregdet shumë i thellë, që përpunon në mënyrë natyrore anije deri në 400 mijë tonëshe.



Porti i Shengjinit


Porti i Shengjinit, për nga pozicioni, lidh Adriatikun Jugor dhe pjesën Mesdhetare Lindore me vendet e Europës Lindore dhe Qendrore. Europorti do të jetë një pikë strategjike dhe e rëndësishme në shkallë evropiane për faktin se lidh Detin Adriatik dhe Detin e Zi në një rrugë më të shkurtër. Bazuar në planin urban të Shqipërisë dhe korridoreve të tranzitit euroballkanik, është kalkuluar se në më shumë se 230 000 kilometër katror të Ballkanit nevojitet tranziti i mallrave nëpërmjet portit, duke nënkuptuar një minimum prej 40 milionë ton mallrash në vit. Projekti Europort është rekomanduar edhe nga familja Rothschild si një projekt shumë fitimprurës dhe i një rëndësie të madhe.

orel

Europorti i Shengjinit
Portali i ndertimit

Me shume projekte ne Shqiperi






Embassy Residence




Lakeview Residences



Mandarine Drive, Lunder, Tirane




MET Building Tirana



Godine Polifunksionale Europiane Blloku




2B & CONSTRUCTION GROUP - Godinë banimi dhe shërbimesh 1,5,7 dhe 9 kate me 1 kat parkimi nëntoke në rrugën Frosina Plaku



HALILI SH.P.K - Godine banimi dhe sherbime 1-7,5,7,8 dhe 9 kate, 3 kate parkim nentoke



E-88 shpk - Godine banimi dhe sherbime 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkim, Rruga e Durresit



Zyrat e reja te FSHF dhe rikonstruksioni i Fushave te Futbollit

SHTOJCA P32

A1 Report – pamje e përshkrimit të lajmit të 11.09.2014 (pjesërisht e përsëritur me P30)

Burimi i bashkëlidhur: kopje e materialit të dorëzuar për shqyrtim. Faqet vijuese riprodhojnë dokumentin pa ndryshime përmbajtësore.



Description

A1 Report - 'Rruga e Arbrit', Shqipëria e Kina drejt përfundimit të marrëveshjes

2	1,715	2014
Likes	Views	11 Sept

PEKIN - Qeveria shqiptare dhe ajo kineze janë në prag të përfundimit të një marrëveshje për financimin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Lajmi është bërë i ditur nga vetë kryeministri shqiptar Edi Rama gjatë një interviste për radion e jashtme kineze 'CRI'.

Rama është shprehur se për ndërtimin e 'Rrugës së Arbrit' ka biseduar me homologun kinez Li Keqiang, me të cilin zhvilloi një takim zyrtar ditën e djeshme. Takimi i dy kryeministrave u zhvilluan në Tianjin, ku të dy udhëheqësit ndodheshin për të marrë pjesë në Forumin Veror Ekonomik të Davosit.

Ndër të tjera Rama theksoi gjithashtu se qeveria kineze ka paraqitur interes edhe në sektorë të tjerë të infrastrukturës si ai për projektin e hekurudhës shqiptare, "Korridorin e Kaltër" si dhe portin e "Shëngjinit".

SHTOJCA P33 — TAKIMI NË BUKURESHT, 26–27 NËNTOR 2013

Korrigjim i identifikimit të fotografisë dhe dokumentim i takimit

Burimi zyrtar kinez (Xinhua, botuar më 28.11.2013) konfirmon takimin e Kryeministrit shqiptar Edi Rama me Kryeministrin kinez Li Keqiang më 27.11.2013 në Bukuresht. Sipas raportimit, në bisedë u trajtua bashkëpunimi për infrastrukturën e transportit, përfshirë rrugët, hekurudhat dhe portet.

Fotografia në krye të artikullit zyrtar kinez paraqet Li Keqiang me Kryeministrin e Malit të Zi, Milo Đukanović, në një takim tjetër. Ajo nuk është fotografi e Edi Ramës dhe nuk përdoret këtu si provë fotografike e takimit Rama–Li.

Ekziston edhe një fotografi arkivore në grup nga samiti në Bukuresht, datë 26.11.2013, e publikuar në Wikimedia Commons me burim Partidul Social Democrat (Rumani), licenca CC BY 2.0. Katalogizimi i saj përfshin edhe Edi Ramën. Fotografia dokumenton pjesëmarrjen në samit, jo takimin dypalësh të 27.11.2013.

Burimet, të aksesueshme me lidhje ose kode QR:

1. Raporti zyrtar kinez mbi takimin Rama–Li

https://english.www.gov.cn/premier/news/2014/08/23/content_281474983009134.htm

2. Fotografia arkivore e samitit, 26.11.2013

Hap fotografinë në Wikimedia Commons (CC BY 2.0)

Kufizimi provues: As raporti dhe as fotografia nuk provojnë vetvetiu se dokumentacioni teknik i projektit Europort Shëngjin iu dorëzua palës kineze.

Shënim: Fotografia e arkivit jepet me lidhje të verifikueshme dhe kod QR, jo si imazh i riprodhuar në këtë faqe.

SHTOJCA P34 – BOTIME TË GAZETËS SHQIPTARJA.COM, 27.11.2013

Dosja: Europort Shëngjin – “Eagle of the Adriatic”. Referencë: nr. 7284; shkresa nr. 7284/4, datë 05.10.2026.

1. Gazeta Shqiptarja.com, faqja 12

Artikulli “Edmond Haxhinasto: Porti i ri të Shëngjinit është projekt strategjik” përmend Europort Shëngjin dhe Lirim Muharemin. Ky publikim bashkëkohor duhet vlerësuar në lidhje me dokumentacionin teknik, shkresat dhe provat e tjera të paraqitura në dosje. Publikimi, i marrë veçmas, nuk është dokument titulli juridik.

2. Gazeta Shqiptarja.com, faqja 7

Artikulli “Kryeministri Rama me homologun kinez: Gati për investimet” shoqërohet me fotografi nga takimi në Bukuresht dhe përshkruan diskutime mbi investimet e bashkëpunimin ekonomik. Ai nuk përmend shprehimisht projektin Europort Shëngjin, prandaj vlen si provë kontekstuale dhe kronologjike, jo si provë e drejtpërdrejtë e identitetit të projektit.

3. Ruajtja e provës

Faqet origjinale të gazetës paraqiten më poshtë si riprodhime të plota fotografike. Renditja e tyre është faqja 12 dhe faqja 7 e botimit të datës 27.11.2013. Kjo shtojcë plotëson P20–P33 pa ndryshuar përmbajtjen e tyre.

Kompania italiane ofron mbulimin e gjithë destinacioneve

"Alitalia" shpëton klientët e "Belle Air"-it

Rreth 1.000 vetë fluturuan me "Blue Panorama"



Zhbllokimi
ILIR SINANAJ
TIRANE

Kompania e njohur italiane "Alitalia" është ofruar të shpëtojë pasagjerët shqiptarë, të "lënë në baltë" nga "Belle Air", e cila shpalli falimentimin pa paralajmërur ar klientët, që kanë prerë 52 mijë bileta udhëtimi deri në mars të vitit të ardhshëm. Veprimi i kompanisë gatimonopol të transportit ajror në Shqipëri, ka vënë në lëvizje dikasteret qeveritare gjatë ditëve të fundit. Ministri i Transportit Haxhinasto u shpreh djese do të merreshin të gjitha masat për të gjetur një zgjidhje për udhëtarët e kompanisë "Belle Air", pasi kjo kompani pezulloi fluturimet. Ai ka pritur në një takim me përfaqësues të kompanisë ajrore "Alitalia", për të diskuar pikërisht për çështjen e udhëtarëve të braktisur nga "Belle Air", që, sipas deklaratave të përfaqësuesve të saj, ndodhet në vështirësi financiare. Gjatë takimit, drejtues të kompanisë italiane kanë shprehur gadishmërinë për të ndihmuar pasagjerët, të cilëve iu pezulluan fluturimet. Nga ana e tij, ministri Haxhinasto e ka vlerësuar gadishmërinë e kësaj kompanie

> **Zgjidhja**
> Ministri i Transportit Haxhinasto u shpreh dje se do të merreshin të gjitha masat për të gjetur një zgjidhje për udhëtarët e kompanisë "Belle Air"

për t'u zgjidhur problemin pasagjerëve të "Belle Air". Përfaqësuesit e "Alitalias" deklaruan se janë të gatshëm të mbulojnë të gjitha destinacionet e fluturimit që "Belle Air" nuk do të mbulojë më tej, duke ofruar edhe shërbimin e kompanisë tjetër italiane "Air One". "Do plotësojmë nevojat e udhëtarëve të "Belle Air". Mirëpresim pasagjerët që kanë blerë biletat para 22 nëntorit. Të gjitha nismat e reja do të komunikohen në vijim", u njoftua zyrtarisht nga selia e kompanisë "Alitalia" në Romë. Ndërkohë, dje erdhi edhe reagimi nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës për çështjen "Belle Air". Në të theksohet se është njoftuar për pezullimin e fluturimeve nga kompania "Belle Air" në të njëjtën ditë me median. "Jemi njoftuar për pezullimin më datë 24 nëntor. Për pezullimin u informuam në të njëjtën ditë me median. Shqetësimi i kuptueshëm është ndjekur hap pas hapi", thuhet në njoftimin e Aeroportit.

RIMBURSIMI

Udhëtarëve, që kishin prerë bileta për të fluturuar me kompaninë ajrore "Belle Air" dhe që u lanë lënë në mëshirë të fatit nga kjo kompani, pasi ajo në një vendim të papritur pezulloi të gjitha fluturimet, u janë vënë ditën e djeshme në dispozicion avionë nga kompania italiane "Blu Panorama Airlines". Por, sipas burimeve të brendshme të Aeroportit "Nënë Tereza", midis saj dhe "Belle Air" duket se ka një kontratë me karakter të përkhshëm dhe të shkurtër. Ndërkohë, "A1 Report" ka provuar të kontaktojnë Agjencinë e Aviacionit Civil për t'u informuar mbi mënyrën se si funksionon skema e rimbursimit të pasagjerëve të "Belle Air" nga kompania italiane "Blu Panorama Airlines", por ky institucion u ka mbyllur

→


Edmond Haxhinasto: Porti i ri të Shëngjinit është projekt strategjik

Vizitorë të shumtë në panairin e sigurisë, i pranishëm ministri Tahiri

Panairi
TIRANE

Një prej projekteve më serioze të infrastrukturës shqiptare, ai i ndërtimit të Portit të ri të Shëngjinit do t`i prezantohet qeverisë kineze për sigurimin e një financimi për ndërtimin e tij - deklaroi Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës Edmond Haxhinasto para medies së pranishme dje gjatë vizitës në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës të organizuar nga Klik Ekspo Group. Gjatë vizitës dhe takimeve me kompanitë pjesëmarrëse, Ministri Haxhinasto ndaloi dhe në stendën e Europort Shëngjin "Shqiponja e Adriatikut". Gjatë bisedës me Lirim Muharemin, drejtuesin e kompanisë LM & Co, Ministri Edmond Haxhinasto tha se, qeveria e vlerëson projektin e realizuar dhe se do të japë mbështetjen maksimale për gjetjen e fondeve. Ministri Haxhinasto përgëzoi dhe organizatorët e Klik Ekspo Group për mbështetjen që i japin biznesit vendas dhe të huaj dhe rrjedhimisht ekonomisë shqiptare. Në ndalesën në stendën e Europort Shëngjin "Shqiponja e Adriatikut", ministri sqaroi për mediat se ky është ndër projektet më madhore të infrastrukturës dhe është projekt që plotëson nevojat e vendit.

"Një nga stendat ku unë kam ndaluar me interes të veçantë është kjo këtu, që bën prezantimin e një projekti si ai për Portin e ri të Shëngjinit. Dëshiroj të shpreh vlerësimin tim maksimal për zotin Lirim Muharremi, për sipërmarrjen e tij, për realizimin e këtij projekti, i cili në fakt është një projekt



shumë strategjik që përputhet dhe me strategjinë tonë të zhvillimit të infrastrukturës së Shqipërisë. Ne tashmë këtë projekt e kemi bërë pjesë të planeve tona strategjike për zhvillimin e transportit dhe infrastrukturës dhe jemi duke punuar që të garantojmë interesin, pjesëmarrjen dhe investimet e kompanive prestigjoze", - tha Haxhinasto në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës. Ministri i Transporteve dhe Infrastrukturës u shpreh i bindur se ndërtimi i portit të ri modern do t`i vlejë të gjithë rajonit. "Ne do përpiqemi maksimalisht që të gjejmë një investitor strategjik për të bërë të mundur realizimin e këtij projekti kaq të rëndësishëm, që nuk është projekt vetëm për Shqipërinë, por për Kosovën, Serbinë, Bullgarinë dhe për gjithë rajonin. Është një nyje me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim për Shëngjinin dhe gjithë Shqipërinë", - tha ministri Haxhinasto.

Porti i Shëngjinit shihet si një projekt infrastrukturor që i shërben drejt për së drejti një hapësire prej 230 mijë kilometra katror të Ballkanit, pasi do të transportohen 30-40 milion ton mallra me një vlerë transporti rreth 550 milionë euro. Projektuesi thotë se kalimi nëpërmjet Portit të Shëngjinit do të thotë një kursim prej 360 milionë litra karburante në vit. Me shkurtimin e rrugëve do të kemi dhe më pak lëshim të gazit karbonik në atmosferë, pra më pak ndotje për të gjithë Ballkanin.

MINISTRI TAHIRI VIZITON ALMEX

Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Artan Didi kanë vizituar ambientet e Panairit Ndërkombëtar Klik Ekspo Group. Veç stendave të shumë kompanive të huaja, të pranishme në këtë Panair, Ministri Tahiri është ndalur më gjatë në pavionet e rezervuara për Ekspozitën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Sigurinë ALMEX III. Për herë të parë Ministria e Brendshmë është afruar si një prej bashkëpunëtorëve kryesor në këtë Panair dhe ka vënë në dispozicion të publikut shqiptar dhe jo vetëm, të gjitha asetet e saj, duke nisur nga stendat e Policisë së Shtetit, Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, Forcave Speciale RENEA, Shërbimit të Emergjencave Civile, Gardës së Republikës dhe shumë institucione të tjera në varësi të kësaj Ministrie.

Gjatë vizitës së kryer në ambientet e Panairit Ndërkombëtar Klik Ekspo Group, Ministri Tahiri është ndalur dhe tek stenda e rezervuar për historikun e Policisë së Shtetit, ku veç armëve të përdorura ndër vite, janë ekspozuar dhe uniformat e Policisë që nga viti 1913 e deri më sot. Një pavion ky që ka tërhequr interesin dhe të shumë qytetarëve të thjeshtë, të cilat janë njuhur nga afër historikun e Policisë së Shtetit ndër vite. Një prej objekteve të ekspozuara që ka shfaqur më shumë interes në këtë pavion, është pistoleta e Xhevdet Mustafës, një prej personazheve më të njohur gjatë kohës së sistemit komunist, misioni i të cilit ishtë të vriste Enver Hoxhën. Interes tek vizitorët kanë shfaqur dhe mjetet e emergjencave civile, të cilat janë të ekspozuara në pjesën e jashtme të Panairit. Borëpastruese, zjarrëfikëse, autoshakllë, automjete për koordinimin e emergjencave, të paisura me teknologjinë më të fundit, janë vetëm disa nga mjetet e punës së përditshme të kësaj Drejtorie, të cilat mund të vizitohen në ambinetet e Panairit Ndërkombëtar të Klik Ekspo Group në Pallatin e Kongreseve. Po ashtu, kuriozitet të shumtë ka pasur dhe në stendën e Policisë Rrugore, ku jo pak vizitor kanë parë dhe provuar tubat e alkoolit dhe radërët e shpejtësisë, të cilat janë disa prej mjeteve kryesore të punës të Policisë Rrugore.

Ndërkaq, Forcat Speciale RENEA për shkak edhe të reputacionit të tyre, kanë pritur gjatë këtyre ditëve të Panairit me mijëra vizitor të cilët kanë parë nga afër të gjitha mjetet e punës të efektivëve më të përgatitur të Policisë së Shtetit. Mes objekteve të ekspozuara ishin snajperat për distanca të largëta, bombat tymuese, kamerat termike, automatikët dhe pistoletat e efektivëve si dhe mjetet mbrojtëse, duke nisur nga helmetat, antiplumbët e deri tek veshjet e posaçme për grupet e polumbarëve.

Cyan magenta yellow black

Integrimi

JAKIN MARENA
TIRANE

PE: Refuzimi i armëve kimike shenjë pjekurie dëgjoi popullin

Komiteti i Jashtëm diskuton rezolutën: Shqipëria e meriton statusin në BE

Parlamenti Evropian ka vlerësuar refuzimin që Shqipëria i bëri armëve kimike të Sirisë, me gjithë këmbënguljen amerikane, duke e cilësuar shenjë e pjekurisë politike. Eurodeputetët, u shprehen përgjithësisht në mbështetje të Këshillit të Evropës për t'i dhënë Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Komiteti i Jashtëm në PE diskutoi draftrezolutën për Shqipërinë, përpiluar nga raportuesi i ri kroat, Nikola Vuljaniç, ku u vërejtën suksese t e Shqipërisë dhe problemet. "Për mua ka dy qëllime, së pari për të ndihmuar vendin, duke mbështetur raport-progresin e Komisionit e duke ofruar arsye shtesë ndaj Këshillit për t'i dhënë Shqipërisë statusin kandidat. Arsyeja tjetër është stabiliteti rajonal e forcimi i pozicionit e politikës së Unionit që thotë se arritjet duhen respektuar e shpërblyer në rrugën e integrimit. E nuk ka dyshime për arritjet, pjekuria politike u dëshmua me refuzimin e shkatërrimit të armëve kimike siriane në Shqipëri. Me gjithë insistimin e SHBA, qeveria shqipëtare dëgjoi popullin", tha Nikola Vuljaniç në PE. Ndërsa Jelko Kacin raportues për Serbinë tha se ajo çfarë mungonte prej disa vitesh ishte një raportues proaktiv mbi Shqipërinë. "Megjithëse erdhi shumë vonë, në fund të fundit u shënua një kontribut i madh për të mobilizuar e



Shqetësimi
"Shqipëria është një anëtare e plotë e Konferencës së Organizatës Islamike, gjë e pazakonshme për Ballkanin. Kjo shkakton ca dilema në politikën e jashtme, kurdo që t'i bashkohet BE, për mënyrën se si aleatët votojnë në OKB", tha Tannock, britanik, konservator.

për të vërtetuar përpjekjet e Shqipërisë", tha ai. Ndërsa Këshillit i sugjerohet të shmangë "vonesa të panevojshme" për statusin në Dhjetor, kërkohet dialog politik reforma të qëndrueshme për të siguruar pavarësinë e institucioneve, gjyqësorit, administratës e medias, krahas luftës kundër korrupsionit, krimit e trafiqeve. "I bëjmë thirrje Këshillit të njohë progresin e vendit dhe t'i japë statusin kandidat pa vonesë të panevojshme. Por duhet kuptuar gjithashtu me këtë raport se progresi i arritur kërkon më tepër konsolidim e zbatim dhe për reformat e mbetura duhet përshpejtuar miratimi", tha Eduard Kukan, kreu delegacionit për Ballkanin. "Ajo që është më e rëndësishmja për këtë komitet, këtu kemi eurodeputetë gjermanë e hollandezë, është të dërgojmë mesazhe të qarta ndaj qeverive tona, se ne kemi mbërritur në pikën që mbështesim statusin kandidat dhe se Shqipëria e meriton këtë, shqipëtarët e kanë fituar këtë. Nëse bëjmë hap mbrapa, e kemi parë të ndodhë me serbët, ne do humbisnim besimin e i dimë pasojat që do kishim atje. Duhet të jemi shumë të bindës ndaj qeverive të vendeve tona", ka këmbëngulur Knut Fleckenstein, eurodeputet gjerman. Pavarësisht insistimit të raportuesit, rezoluta për Shqipërinë pritet të votohet nga Komiteti më 5 Dhjetor, për t'u miratuar në seancë plenare 10 ditë para dhënies së vendimit nga Këshilli i BE.

REZOLUTA E PLOTË E PARLAMENTIT EVROPIAN

VLERËSIMET E PËRGJITHSHME

- Vlerësohen fryma e bashkëpunimit dhe sjellja e forcave politike gjatë zgjedhjeve të 23 qershorit. Gjithashtu, është parë një frymë kompromisi dhe bashkëpunimi nga palët në të mirë të progresit.
- Integrimi Europian duhet të marrë mbështetje mbarëkombëtare dhe duhet të jetë një projekt që të përfshijë të gjitha palët politike dhe shoqërinë civile.
- Vërejmë se ka patur një progres mjaft premtues në axhendën ea reformave dhe shprehim besim në potencialin, kapacitetin dhe vendosmërinë e Shqipërisë drejt integrimit evropian.
- Mirëpresim vendosmërinë e shtetit ndaj integrimit evropian dhe modernizimin e disa sektorëve kyç të qeverisjes përmes reformave. Inkurajojmë Shqipërinë që të marrë rezultatet e kërkuara nga Komisioni Europian në vitin 2010, veçanërisht në ndërtimin e shtetit ligjor, luftën ndaj korrupsionit e krimit të organizuar.
- Vlerësojmë se këshilli u njoh me progresin e Shqipërisë dhe kërkojmë që t'i jepet statusi i vendit kandidat.

KRITERET POLITIKE

- 6. Kërkojmë që të bëhen përpjekje të mëdha për të forcuar pavarësinë dhe eficencën e sistemit të drejtësës, duke shtuar këtu edhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kërkojmë që përmirësohet qasja ndaj organeve të drejtësisë për këdo që ka nevojë. Kërkojmë që të përmirësohet dhe forcohet puna e autoriteteve që merren me të drejtat e njeriut, siç janë Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit.
- Vlerësojmë vendosmërinë për të luftuar korrupsionin në të gjitha nivelet dhe kujtojmë se duhet ende punë për forcimin dhe koordinimin institucional për këto çështje. Kërkojmë që të qartësohet roli dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Duhet që të monitorohen të gjitha strategjitë antikorrupsion.
- Duhen ende përmirësime në luftën kundër krimit të organizuar dhe duhen bërë përparime në metodologjinë hetimore.
- Vlerësojmë progresin e dialogut mes shoqërisë civile dhe qeverisë, dhe theksojmë që ky dialog të konsolidohet edhe më tej, si në planin e demokracisë, ashtu edhe në përmirësimin legjislativ dhe të reformave.
- Vlerësojmë se minoritetet në përgjithësi gëzojnë respekt dhe garantim të të drejtave të tyre. Kërkojmë që autoritetet të mbajnë dhe të zhvillojnë më tej klimën e tolerancës për gjithë minoritetet në vend. Kërkojmë implementimin e strategjive për integrimin e komunitetit rom në shoqëri, si dhe të komunitetit LGBT. Për këta të fundit, duhen disa rregullime ligjore kundër diskriminimit.
- Ndërkohë që media është pluraliste dhe diverse, ka shqetësime lidhur me influencën politike në mediat publike. Duhet të garantohet liria e medias dhe pavarësia e autoriteteve rregullatore. Duhen bërë transparente rrugët e financimit të tyre.
- Duhet mbështetje më e madhe e reformave dhe implementimit të tyre në fushën socio-ekonomike dhe zhvillimit ekonomik në tërësi.
- Mirëpresim përpjekjen e autoriteteve përkatëse për rritjen e eficencës në mbledhjen e taksave dhe për të luftuar informalitetin. Gjithashtu, përgëzojmë qeverinë për mbështetje dhe provim të punësimit.
- I kërkojmë qeverisë që të garantojë respekt për të gjithë të punësuarit, qoftë në sektorin privat apo publik.
- Duhet vëmendje e veçantë për respektimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve. Duhen investime në ciklin fillor mësimor, si edhe për sektorin shëndetësor që kujdeset për ta. Duhet mbështetje për fëmijët në nevojë.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Vlerësojmë rolin stabilizues të Shqipërisë në Ballkanin perëndimor, veçanërisht në marrëdhëniet me shtetet fqinje, ku ka një komunitet të konsiderueshëm shqiptarësh.
- Vlerësojmë refuzimin e qeverisë së re shqiptare ndaj nacionalizmit dhe diskursit që e rxit atë. Inkurajojmë politikat tolerante ndaj kësaj çështje në çdo instancë qeverisëse.

Takimi

BUKURESHT

Kryeministri Rama me homologun kinez: Gati për investimet

Në takim me 16 krerët e qeverive evropiane të ftuar nga Li Keqiang

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në takimin e krerëve të qeverive të Evropës Qendrore dhe Juglindore e Kryeministrit të Republikës Popullore të Kinës që u zhvillua në Bukuresht. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe Kryeministri i Rumanisë, Bullgarisë, Kroacisë, Çekisë, Estonisë, Hungarisë, Lituanisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Polonisë, Serbisë, Sllovakisë, Sllovenisë dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës.

"Në Bukuresht me 16 kryeministra të Evropës Qëndrore e Lindore të ftuar nga kryeministri kinez Li Keqiang për të futur në rrugën e realizimit një numër të madh projektesh në kuadrin e një programi shumë ambicioz financimi e bashkëpunimi të Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për këto vende. Nesër(sot) diskutojmë projektet e Shqipërisë me optimizëm për vlerën tërheqëse të tyre si edhe për idetë tona të reja për rritjen e investimeve kineze në



Shqipëri", ka shkruar kryeministri Rama në profilin e tij në rrjetin social facebook, të shoqëruar dhe me fotot përkatëse. Në këtë takim u bisedua për rëndësinë e bashkëpunimit mes vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore dhe Kinës, duke u përqëndruar kryesisht në fushat e ekonomisë dhe tregtisë. Përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse theksuan se ky bashkëpunim merr shkas nga partneriteti strategjik mes Bashkimit Evropian dhe Kinës dhe u shprehën të gatshëm për ta forcuar edhe më tej këtë bashkëpunim duke zhvilluar mbledhje të përvitshme të krerëve të qeverive dhe duke promovuar investime në ekonomi dhe tregti. Gjatë fjalës së tij, Kryeministri Rama theksoi rëndësinë që viti 2014 ka për rajonin, si i pari vit që e gjen Ballkanin në paqe të plotë. Kryeministri Rama tha se ky moment i ri duhet shfrytëzuar për të bashkëpunuar sa më ngushtë me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore për të nxitur investime rajonale, sidomos në fushën e transportit dhe energjisë. Rama shoqërohej nga Zv.kryeministri Niko Peleshi, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Arben Ahmetaj, si edhe deputeti Taulant Balla. Kryeministri Rama do të zhvillojë një sërë takimesh dypalëshe.